



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 21.06.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N/10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Igor Simiç, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi;

Munguan: Nezir Çoçaj;

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ediar Krasniqi- KDI, Fitore Sopjani- Praktikante -Zyra për informim, Norë Shabani -Koha Ditore, Rreze Hoxha - GLPS, Adem Gashi -Ambasada Amerikane, Berita Abazi dhe Avni Zogiani - LV, Blerim Sallahu -Kuvendi i Kosovës, Genc Nimani dhe Anton Demhasaj -Çohu, Shaban Murturi - EUO/EUSR, Fikrete Shabani - Zëri, Valbona Bytyqi -Ekonomia Online, Beadin Sylja -Kosovapress, Adelina Ahmeti - Kallxo.com;

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu-Kryetare e komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projekt-Rregulloren e Kuvendit;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje;
5. Të ndryshme.

Hajdar Beqa, kërkoi nga Kryetarja e Komisionit, që pika dy e rendit të ditës të shtyhet në mënyrë që të presin edhe Ligjin nga Qeveria, dhe më pas të formohet grupi punues ku do të shikohen dy ligjet, me mundësi që të inkorporohen në një ligj të dyjat.

Kryetarja, konfirmoi se çështja është diskutuar, dhe se Ministria e Drejtësisë ka propozuar këtë projektligj, por sipas saj asnjëra nuk e pengon tjetrën, pasi njëra e ndjekë pasurinë e pajustificueshme, ndërsa nisma e Ministrisë së Drejtësisë ka të bëjë me vepër penale. Propozimi i parë sipas znj. Haxhiu është nisma e grupit parlamentar Vetvendosje dhe nuk ka asnjë arsytim që ta largohet nga rendi i ditës, për çka edhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, që ta procedojnë në seancën e Kuvendit.

Hajdar Beqa, në fjalën e tij të sërishme kërkoi që të merren të dyja ligjet të krahasohen duke kërkuar që të mos krijohen praktika të tilla, ai shtoi duke thënë se duhet të kemi ligje në harmonizim me ligjet dhe me objektivat që i ka edhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Deputeti Beqa përsëri kërkoi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

Kryetarja, në fjalën e saj të sërishme sqaroi edhe një herë duke thënë se ky projektligj ka për objekt të shqyrtimit pasurinë e pajustificueshme, jo personat. Ajo tha se VV ka një strategji legjislative prandaj edhe kjo është një nismë tjetër nga ato të mëparshmet që janë procesuar tash e një kohë në Kuvend.

Sami Kurteshi, nuk e përjashtoi mundësinë që komisioni të nxjerr pjesët ma të mira, dhe nuk sheh ndonjë arsye që të mos diskutohet për përmbajtjen.

Korab Sejdiu, pajtohet se fjala është për dy çështje të ndryshme, të cilat mund edhe të harmonizohen më vonë nëse qëllimi është i tillë, dhe sipas tij në bazë të neni 79, deputetët e Kosovës kanë të drejtë për nisma legjislative. Ai theksoi se ekziston mundësia se nëse vendoset për heqje të pikës sipas arsytimit të lartë cekura, mos po cenohet një e drejtë kushtetuese që i takon deputetëve përkatësisht grupeve parlamentare.

Shkumbin Demaliaj, tha se në takimin e kaluar jemi marr vesh për këtë projektligj dhe nuk e ka kundërshtuar askush. Kërkesa është që ta marrim edhe projektligjin që e bie Qeveria, e harmonizojmë dhe i konsultojmë dy ligjet, dhe pastaj nëse është e nevojshme këtë të vetvendosjes e shtyjmë përpara, megjithatë propozoi që duhet të presin projektligjin nga qeveria dhe të harmonizohen të dy projektligjet.

Arben Gashi, tha mbetet në dorën e propozuesit se a don me vazhdu përpara me këtë projektligj, andaj edhe kërkoi që të qitet në votim.

Bilall Sherifi, tha se është kundër kësaj qasje për ta trajtuar këtë materie. Por pasi të jemi tek momenti procedural vazhdojmë procedojmë siç kërkohet.

Pasi nuk kishte diskutime tjera kryetarja konstatoi se me nëntë vota “për” dhe “një” apstenim miratohet rendi i ditës pa ndryshime

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme;

Kryetarja, paraqiti për diskutim nismën e Lëvizjes Vetëvendosje për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme, duke dhënë një arsyetim të shkurtër rreth përmbajtjes dhe rëndësisë së këtij projektligji. Ajo tha se objekti që trajtohet me këtë projektligj është pasuria e pajustificueshme dhe jo domosdo personi. Barra e provës në këtë rastë i bie të pandehurit dhe jo siç është aktualisht prokurorit, prandaj konsiderojmë se është i rëndësishëm ky projektligj duke marrë parasysh faktin që edhe në raportin për vendin evidentohet fakti që Kosova ka mungesë të pakos ligjore kundër korrupsionit, gjegjësisht mungesë të Ligjit Antimafia ku ky ligj edhe përfshihet pak a shumë në nismën legjislative të Vetëvendosjes theksoi deputetja Albulena Haxhiu.

Shkumbin Demaliaj, kërkoi paraprakisht që të dy projektligjet të përcjellën në Zyrën Ligjore në Kuvend për të bërë një krahasim dhe mos ti bëjmë dy ligje me kuptim të njëjtë.

Bilall Sherifi, tha se është kundër këtij ligji sepse ky ligj ndryshon filozofinë e drejtësisë. Por ndryshon edhe komplet qasjen e asaj që quhet barrë e provës. Barra e provës në asnjë vend nuk vihet tek i pandehuri por gjithmonë shteti ka për detyrë të dëshmoj fajësinë ndërsa i pandehuri të dëshmoj pafajësinë. Në esencë nëse një pasuri qenka e pajustificueshme i bie që ajo është fituar me vepër penale. Dhe nëse është fituar me veprime të paligjshme atëherë së pari duhet të konfirmohet e pastaj të merren masat ashtu siç e parasheh ligji. Megjithatë mendoj që ka elemente të mira në ligj të cilat do të mund të përfshiheshin tek Ligji për konfiskimin e pasurisë me vepër penale.

Arben Gashi, tha se çështja duhet të trajtohet me seriozitetin që e meriton. Qysh në të drejtën romake është vendos parimi që barrën e dëshimsë për pretendimin e kryerjes së veprës penale e ka ai që e akuzon. Pra prezumimi i pafajësisë këtu bie poshtë, vendoset një rend i ri. Në këto rrethana është komplekse. Ai tha se nuk e sheh iniciativën si të paarsyeshme por abstenon derisa të vij edhe ligji tjetër, në mënyrë që të analizohen dy variantet.

Korab Sejdiu, duke i'u referuar dy projektligjeve ai tha se fjala është për dy çështje të ndryshme, dhe shprehi dyshime se si do mund të harmonizohen në të ardhmen. Z. Sejdiu pyeti se çfarë praktika janë marr parasysh kur është hartuar projektligji, dhe se cilat praktika janë marrë, a janë marrë praktika nga vendet me rrethana përafërsisht të ngjashme?

Frashër Krasniqi, tha se në parim e përkrahë këtë ligj dhe se Kosova ka nevojë shumë për një ligj të tillë, por pavarësisht mbështetjes, ai kërkoi që ky ligj të vjen edhe si rezultat i një diskutimi më të gjerë ku do merreshin parasysh të gjitha vërejtjet për të cilat u diskutuan sot.

Hajdar Beqa, u deklarua kundër këtij projektligji në parim, duke theksuar se disa nene të këtij ligji e përmbysin sistemin e drejtësisë dhe shkelin edhe Kushtetutën.

Kryetarja, theksoi se projektligji ka nevojë për amendamente që e fuqizojnë dhe i largojnë hapësirat e keqpërdorimit apo heqin mundësitë e interpretimeve apo arbitrariteteve, duke potencuar se këtë projektligj e kanë shumica e shteteve të Bashkimit Evropian

Arben Gashi, tha te jetë dakord me znj. Haxhiu që duhet të vendosim një standard të ri, por ai u shpreh me dyshime nëse ky standard i cili po proklamohet është i studiuar mirë.

Sami Kurteshi, tha se gjendja e krijimit të pasurisë në Kosovë është shumë e rëndë. Ky ligj e ka një qëllim dhe ai qëllim është ajo pika e fundit. Ky është ndryshimi, synon që çdo pasuri të justifikohet.

Pas diskutimeve kryetarja konstatoi se me katër vota “për” pesë “kundër” dhe një “apstenim” komisioni nxori këtë:

Re k o m a n d i m

Të mos miratohet në parim,Projektligji nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projekt-Rregulloren e Kuvendit;

Hajdar Beqa, tha se në mbledhjen e fundit të komisionit është marr vendim që propozimet që i ka pasur Lidhja Demokratike të kthehen edhe njëherë në grup punues. Ai tha se Rregullorja është kategori kushtetuese, dhe duhet të ketë mbështetjen e 80 deputetëve, dhe pa një konsensus politikë nuk kalon në Kuvend. Sipas tij kjo rregullore i plotëson kushtet për procedim në Kuvend, duke propozuar që të gjitha amendamentet që e kanë përkrahjen e grupit punues të shkojnë me përkrahjen e komisionit dhe të gjitha amendamentet të cilat nuk e kanë përkrahjen e grupit punues në këtë fazë të shkojnë në parlament pa përkrahjen e komisionit.

Kryetarja, u deklarua kundër përkrahjes së amendamenteve në pako,duke thënë se duhet të shqyrtohen secila veç e veç. Propozimi ka qenë që të trajtohen vetëm amendamentet që kanë qenë të LDK-së, dhe jo edhe ato që janë trajtuar bashkë.

Hajdar Beqa, përsëriti se grupi punues ka kryer punën komform Rregullores së Kuvendit që është aktuale dhe komform ligjit.

Korab Sejdiu, kërkoi që diskutimi të shtyhet për javën e ardhshme, propozim me të cilin u pajtua edhe deputeti **Sami Kurteshi** që theksoi se me amendamente janë prekur edhe çështje tjera.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetarja konstatoi se komisioni me shtatë vota “për” “dy” kundër dhe “një” abstenim” nxori këtë:

Rekomandim

- I. Miratohet Raporti me amendamente ne Projekt-Rregulloren e Kuvendit;
- II. Projekt-Rregullorja dhe amendamentet e propozuara,procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;
- III. Amendamentet e miratuara dhe të pa përkrahura nga komisioni, janë paraqitur si aneks i këtij procesverballi.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje për këtë raport.

Meqë nuk kishte diskutime, Kryetarja konstatoi se komisioni me shumicë votash nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 06/L-024 per trajtimin e ndërtimeve pa leje, është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji mund t'i procedohet kuvendit per shqyrtim dhe miratim.

5. Të ndryshme.

Kryetarja i'u rikujtoi anëtarëve të komisionit për vizitën e delegacionit të Kuvendit të Shqipërisë me datë 25 dhe 26 qershor. Ajo tha se qëllimi i vizitës është nënshkrimi i një memorandumit bashkëpunimi me dy komisionet homologe.

Mbledhja përfundoi në orën 13:27

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu

Aneks - amendamentet për Projekt-Rregulloren e Kuvendit

Amendamenti 1 Propozim i deputetes Albulena Haxhiu me përkrahjen e Komisionit funksional

Te neni 2, paragrafi 1.9 të hiqet fjala “jodetyrues” dhe atë si vijon:

1.8. Rezolutë: akt me të cilin Kuvendi tregon gjendjen dhe problemet në një fushë të caktuar dhe masat që duhet të ndërmerren.

Amendamenti 2, Komisioni Funksional

Në nenin 2 pas nënparagrafit 1.2 shtohet një nënparagraf i ri 1.3 me përmbajtjen si vijon:

“**1.3Konferenca e Kryetarëve:** organ i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Renditja e nënparagrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 3, Komisioni Funksional

Në nenin 2, pas nënparagrafit 1.23 shtohet një nënparagraf i ri 1.24 me përmbajtjen si vijon: “**1.24. Grupi joformal: është organizim vullnetar i deputetëve;**”

Amendamenti 4, Propozim i deputetit Hajdar Beqa me përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 12 të Projekt- Rregullores, paragrafi 2 fjalët “Kandidati për nënkryetar i subjektit më të madh parlamentar duhet të jetë i gjinisë tjetër nga ai i Kryetarit,”hiqen.

Amendamenti 5, Tri propozime

A. Propozim i Komisionit Funksional

4. Kryetari i Kuvendit kërkon nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb që të propozojnë 1 (një) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, si dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë, të propozojnë një kandidat për nënkryetar të Kuvendit, të cilët zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

5. Propozimet nga paragrafi 4 i këtij neni bëhen me shkrim, sipas procedurës si vijon:

5.1. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb dhe

5.2. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë propozohet nga shumica e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë.

B. Propozim i Grupit parlamentar 6+pa përkrahjen e Komisionit funksional

Paragrafi 4, i nenit 12, fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë propozohet nga shumica e deputeteve (50% + 1) të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë.

C. Propozim i Grupi Parlamentar “Lista Serbe” pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 12, pas paragrafit 4 shtohen dy paragrafë të reja si vijon:

5. Kryetari i Kuvendit kërkon nga deputetët të cilët mbajnë vendet e garantuara për komunitetin serb, të propozojnë kandidatin për nënkryetar të Kuvendit. Propozimi duhet të vijë nga partia politike e cila mban numrin më të madh të mandateve të garantuara për komunitetin serb.

6. Deputetët për zgjedhjen e të pesë nënkryetarëve të Kuvendit votojnë në pako.

Amendamenti 6, propozim i deputetit Sami Kurteshi pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 15, duhet shtuar edhe dy paragrafë të rinj me numër 4 dhe 5 si vijon:

4. Në rast të largimit, dorëheqjes apo kalimit në Grup tjetër Parlamentar të anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, Kryetarit dhe ndonjërit nga nënkryetarët e Kuvendit, nga Grupi Parlamentar i cili e ka propozuar në Kryesi të Kuvendit, funksioni i tyre në Kryesi pushon me automatizëm.

5. Grupi Parlamentar nga i cili është larguar anëtari i Kryesisë sipas kuptimit të paragrafit 4 të këtij neni, propozon për anëtar Kryesie një deputet në përputhje me nenin 67, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Amendamenti 7, Komisioni funksional

Në nenin 20, pas paragrafit 3 shtohet një paragraf i ri 4 me përmbajtjen si vijon:

”4. Në rast të mungesës së Kryetarit, kryesia mblidhet sipas neni 17 paragrafi 3”

Paragrafi 4 bëhet paragrafi 5.

Amendamenti 8, propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në neni 20 të shtohet një paragraf i ri dhe atë si vijon:

Mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit janë të hapura, përveç në rastet kur diskutohet për çështje konfidenciale të sigurisë dhe për detaje të kontratave që përbëjnë sekret afarist, sipas ligjeve në fuqi.

Amendamenti 9, propozim i deputetes Albulena Haxhiu me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 21, paragrafi 1 të hiqet “nënkryetarët e Kuvendit” dhe të vazhdohet si në projektligj.

Amendamenti 10, propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 21 të shtohet një paragraf i ri dhe atë si vijon:

Mbledhjet e Konferencës së kryetarëve janë të hapura, përveç në rastet kur diskutohet për çështje konfidenciale të sigurisë dhe për detaje të kontratave që përbëjnë sekret afarist, sipas ligjeve në fuqi.

Amendamenti 11 – propozim i deputetes Mexhide Mjaku Topalli pa përkrahjen e Komisionit funksional

Pas nenit 24 të Draft-rregullores të shtohet neni i ri , si vijon:

1. Grupi i Grave Deputete formohet menjëherë pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Të gjitha deputetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë anëtare të Grupit të Grave Deputete.
3. Grupi të Grave Deputete i sigurohet hapësira e punës, stafi i përhershëm (asistente e grupit), buxheti dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin e Grupit të Grave Deputete.

Amendamenti 12, Komisioni Funksional

Në nenin 28, paragrafi 4 në fund të fjalisë shtohen fjalët “përveç në rastet kur mbledhja është e mbyllur.

Amendamenti 13, Komisioni Funksional

Neni 29, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

“1. Grupi parlamentar e propozon kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e komisionit, në përputhje me marrëveshjen e arritur në Konferencën e Kryetarëve siç përcaktohet me nenin 21 paragrafi 7.

Amendamenti 14, Propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 29, paragrafi 4, pasfjalëve “kryesimi i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike shtohen fjalët “kryesimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa” dhe vazhdon si në draft-rregullore.

Amendamenti 15, propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 32 të shtohet një paragraf i ri dhe atë si vijon:

4. Në rastet kur një ministër mungon pa arsye apo refuzon ftesat për të qenë i pranishëm në mbledhjet e komisionit, atëherë Komisioni e thërret në Interpelancë në përputhje me Nenin 85, paragrafët 2, 4, 5, 6 të kësaj Rregullore.

4.1. Në emër të komisionit, interpelancën e thërret kryetari i komisionit apo ndonjëri nga nënkryetarët e komisionit.

4.2. Koha e diskutimeve për grupet parlamentare, është e njëjtë sikur në nenin 85, paragrafi 9.

4.3. ministri nuk mund të refuzojë pjesëmarrjen e tij në Interpelancë.

Amendamenti 16, Komisioni Funksional

Neni 43, paragrafi 2 në rreshtin e tret fjala “përcaktuar” zëvendësohet me fjalën “propozuar” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 17 Propozim i deputetit Dardan Sejdiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 45, të Rregullores së Kuvendit, pas paragrafit 5 të shtohet një paragraf i ri si vijon:

6. “Deputeti i cili dëshiron të vendosë nënshkrimin e tij në listën e nënshkrimeve me kërkesën e kërkuarit apo me vetë dëshirën e deputetit, por që për shkak të ndodhjes së tij jashtë vendit ai nuk mund të bëhet pjesë e kërkesës, në këtë rast, deputeti i tillë mund të bëhet pjesë e listës nënshkruese përmes dërgimit të një e-maili drejtuar kërkuarit me një tekst të tillë: “Përmes këtij e-maili, si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës e konfirmoj nënshkrimin tim në lidhje me kërkesën për seancë të jashtëzakonshme, në lidhje me temën _____ të përfaqësuar nga deputeti _____.”

Amendamenti 18, Komisioni FunkSIONAL

Neni 46, paragrafi 1, pas fjalëve “ miratimit në parim” shtohen fjalët “ me përjashtim të gjendjes së jashtëzakonshme.”

Amendamenti 19, propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 49, paragrafi 4 të hiqet dhe formulohet si vijon:

4. Pas deklarimit të deputetëve dhe grupeve parlamentare, Kryeministri apo ministrat kanë të drejtën e replikës vetëm për çështjet e ngritura nga deputetët.

Amendamenti 20, Propozim i Komisionit FunkSIONAL

Në nenin, 55 paragrafi 3, në rreshtin e tetë fjalët “ dhe me ligj” hiqen dhe teksti vazhdon si në Projekt-rregullore.

Amendamenti 21, propozim i deputetit Sami Kurteshi me përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 55 pas paragrafit 3 shtohet një paragrafi i ri me përmbajtjen si vijon:

Gjatë votimit në seancë plenare, vota të vlefshme për kuorum llogariten atëherë edhe deputet fizikisht të pranishëm në seancë, të verifikuar nga administrata dhe kryesuesi. Votat e deputetëve, të cilët fizikisht janë të pranishëm në seancë, por që nuk votojnë në asnjë mënyrë, llogariten si vota të pavlefshme për vendimmarrje, por të vlefshme për kuorum.

Amendamenti 22, Dy propozime

A. propozim i Komisionit FunkSIONAL

Neni 55, paragrafi 11 në fund të paragrafit **hiqen fjalët** “për ditën e nesërme, nëse nuk është ditë pushimi.”

B. propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Paragrafi 11, i nenit 55 duhet të riformulohet dhe atë si vijon:

1. Në rast të mungesës të kuorumit për vendimmarrje, gjatë votimit, votimi mund të përsëritet vetëm edhe një herë. Votimi i dytë bëhet menjëherë pas votimit të parë. Nëse edhe më tej nuk ka kuorum atëherë kryesuesi i seancës e ndërpret seancën dhe cakton vazhdimin e seancës për ditën e nesërme, nëse nuk është ditë pushimi.

Amendamenti 23, Komisioni FunkSIONAL

Në nenin 58, paragrafi 1 në rreshtin e pestë pas fjalës “vërejtje” shtohen fjalët “ duke deklaruar se është duke përdorur gjuhë joparlamentare.”

Amendamenti 24, propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 67 riformulohet si vijon:

Tërheqja e projektligjit

Propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit në Kuvend, deri para votimit në shqyrtimin e parë në seancë plenare. Për tërheqjen e aktit, para shqyrtimit në seancë plenare, propozuesi e njofton me shkrim Kryetarin e Kuvendit i cili i njofton deputetët në seancën plenare të radhës.

Amendamenti 25, propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Paragrafi 6 i nenit 70 të hiqet

Amendament 26,propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 71 i projektligjit duhet të hiqet.

Amendamenti 27 dy propozime

A. Propozim i deputetit Hajdar Beqa me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 75 i Projekt-Rregullores, paragrafi 7 hiqet.

B. Propozim i deputetit Sami Kurteshi pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 75, paragrafi 7 duhet të riformulohet si vijon:

1. Tekstet e marrëveshjeve ndërkombëtare, që kërkojnë ratifikimin në Kuvend, siç përcaktohet me nenin 18 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet t'i dërgohen Kuvendit për shqyrtim para miratimit, autentifikimit dhe nënshkrimit të së njëjtës me partnerët ndërkombëtarë.

Amendamenti 28, propozim i deputetes Albulena Haxhiu me përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 82 shtohet një paragraf i ri dhe atë si vijon:

9. Në rast se ministri nuk mund të jetë i pranishëm në kohën e pyetjeve parlamentare, e njofton paraprakisht Kryetarin apo nënkryetarët e Kuvendit për mungesën e tij.

10. Në rast të mungesës së tij pa arsye, i tërhiqet vërejtja publikisht nga kryesuesi i seancës për qasjen mospërfillëse ndaj Kuvendit dhe deputetit.

Amendamenti 29, propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 88, paragrafi 7 pas fjalës “por nuk i nënshtrohet votimit” shtohen fjalët “përveç rekomandimeve për institucionet” dhe vazhdohet si në draft.

Amendamenti 30, propozim i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 112 riformulohet si vijon:

1. Seancat plenare të Kuvendit, mbledhjet e komisioneve, mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit dhe mbledhjet e Konferencës së kryetarëve, janë publike, përveç kur Kuvendi, komisioni, Kryesia dhe konferenca e kryetarëve vendosin ndryshe.

Amendamenti 31 dy propozime

A. Propozim i Komisionit Funksional

Neni 118 riformulohet si vijon:

Neni 118 Shmangiet nga Rregullorja

Për t’iu shmangur Rregullores Kuvendi vendos me 2/3 (dy të tretat) e deputetëve të pranishëm në mbledhje plenare. Shmangia mund të bëhet kur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetues së Republikës së Kosovës dhe me standardet evropiane.

B. Propozim i Grupi Parlamentar “Lista Serbe” pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 118 plotësohet si vijon:

Me propozim të Grupit Parlamentar, Kuvendi vendos me 2/3 (dy të tretat) të të gjithë deputetëve, duke përfshirë edhe 2/3 (dy të tretat) e të gjithë deputetëve të të gjitha komuniteteve jo shumicë, për shmangie nga Rregullorja e punës, në rastet kur kjo shmangie ka të bëjë me të

drejtat dhe interesat e komuniteteve joshumicë. Shmangia nuk mund të bëhet për dispozita që janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet Republikës së Kosovës.

Amendamenti 32, Propozim i deputetes Albulena Haxhiu me përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 119 pas fjalës peticioneve shtohet apo referendumeve dhe vazhdohet si në draft.

Amendamenti 33, propozim i deputetes Saranda Bogujevci pa përkrahjen e Komisionit funksional

1. Për formimin e Komisionit Parlamentar, i cili komision merret drejtpërdrejt me luftën e fundit në Kosovë.

Amendamenti 34, propozim i Komisionit Funksional

Neni 3: Parimet e Përgjithshme të Etikës, pas paragrafit 7, shtohet paragraf i ri 8:

“8. Të sigurojë një mjedis pune pa ngacmime seksuale, duke shmangur çdo sjellje me natyrë seksuale që prek dinjitetin e cilitdo dhe që konsiderohet e papranueshme, e papërshtatshme dhe ofenduese për personin tjetër, si dhe krijon një mjedis pune shqetësues, të paqëndrueshëm, armiqësor dhe frikësues.”

Paragrafi 8 bëhet 9.